

PËRPARIMI I PJESËMARRJES QYTETARE në bërjen dhe realizimin e buxhetit komunal

ENHANCEMENT OF CIVIL PARTICIPATION
in preparation and realization of the municipal budget



 **KDI**
Instituti Demokratik i Kosovës
Kosova Democratic Institute
www.kdi-kosovo.org

Tetor 2011

PERSONELI

Ismet KRYEZIU - Drejtor Ekzekutiv

email: ikryeziu@kdi-kosova.org

Vjollca VOGËL - Menaxhere e administratës dhe financave

email: vjollca@kdi-kosova.org

Leonora CIKAJ - Asistente për administratë dhe financa

email: lcikaj@kdi-kosova.org

Donjeta DRESHAJ - Asistente për administratë dhe financa

email: ddreshaj@kdi-kosova.org

Arsim Gjinovci - IT & Design

email: agjinovci@kdi-kosova.org

**PROGRAMI: QEVERISJA LOKALE DHE
PJESËMARRJA QYTETARE**

Kreshnik BASHA - Koordinator

email: kbasha@kdi-kosova.org

NaimCAHANAJ - Koordinator

email: ncahanaj@kdi-kosova.org

**PROGRAMI: DEMOKRATIZIMI DHE
PRAKTIKAT PARLAMENTARE**

Driton SELMANAJ - Menaxher i programit

email: dselmanaj@kdi-kosova.org

Isuf ZEJNA - Asistent i projektit

email: izejna@kdi-kosova.org

PROGRAMI: TRANSPARENCA DHEANTIKORRUPSIONI

Merita MUSTAFA - Menaxhere e programit

email: mmustafa@kdi-kosova.org

Enis XHEMAILI - Kryesues i hulumtimit

email: exhemaili@kdi-kosova.org

Besnik RAMADANAJ - Asistent i projektit

email: bramadanaj@kdi-kosova.org

Natyra KASUMAJ - Koordinatore

email: nkasumaj@kdi-kosova.org

PROGRAMI: ZGJEDHJET E LIRA DHE TË DREJTA

Liridon SELMANI - Menaxher i programit

email: lselmani@kdi-kosova.org

Përmbajtja

4

I. Hyrje	5
a. Korniza ligjore dhe cikli i planifikimit për bërjen dhe realizimin e buxhetit komunal	5
b. Karakteristikat kryesore të realizimit të buxhetit komunal në regjionin e Prizrenit	7
i. Të hyrat	8
ii. Të dalat - Pagat	10
iii. Të dalat - Mallrat dhe Shërbimet	11
iv. Të dalat - Shpenzimet komunale	11
v. Të dalat - Subvencionet	12
vi. Të dalat - Investimet kapitale	13
vii. Totali i shpenzimeve	14
viii. Të dalat - Qasja në dokumente zyrtare dhe mendimi i zyrtareve komunal ...	14
c. Sfidat kryesore gjatë bërjes së buxhetit komunal	15
II. Rekomandimet	16
Aneks 1	17
Endnota	35

I. Hyrje

Procesi i bërjes së buxhetit komunal është njeri ndër funksionet më të rëndësishme të qeverisjes lokale për arsye se duhet të reflektoj nevojat dhe prioritetet vjetore të komunës gjegjëse. Gjatë këtij procesi duhet të bëhet një planifikim i mirëfilltë dhe si i tillë duhet të jetë i hapur për grupet e interesit me qëllim që të reflektoj sa më mirë interesat e qytetarëve.

Pjesëmarrja qytetare në planifikimin dhe bërjen e buxhetit komunal është aspekt më i rëndësishëm për ndërtimin e një qeverisje të hapur, transparente dhe llogaridhënëse në nivel lokal; Qëllimi i saj është që të përkrah qeverisjen lokale në kryerjen e funksioneve të saja dhe njëkohësisht edhe mundësoj ndërtimin e praktikave të mira të qeverisjes demokratike në nivel komunal. Me qëllim që ky proces të ketë sukses është e domosdoshme që para çdo miratimi të buxhetit për vitin vijues, autoritet komunale të: 1) informojnë popullatën për fillimin e këtij procesi; 2) të organizojnë dëgjime publike dhe marrin parasysh kërkesat e qytetarëve dhe grupeve të interesit; 3) ta publikojnë propozim buxhetin para miratimit të tij dhe të sigurojnë qasje të lirë në këtë dokument; dhe së fundi), të mundësojnë përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në monitorimin e tërë këtij procesi.

Buxheti në vete gërsheton planifikimin dhe aktivitetet që duhet të ndermirën brenda një viti fiskal dhe në vete duhet të përfshij parashikimin e të hyrave dhe shpenzimeve të domosdoshme për plotësimin e nevojave të qytetarëve dhe funksionimin normal të komunës. Periudha buxhetore përmban në vete afatin kohor prej 12 muajsh dhe mbulon kohën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor të atij viti. Propozimi i buxhetit pran Kuvendit Komunës bëhet nga ana e kryetarit të komunës dhe atë pasi që janë respektuar procedurat dhe bërë konsultimet e nevojshme me qytetarët dhe grupet e tjera të interesit. Kjo për arsye se komunat sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, duhet të punojnë për mirëqenien e qytetarëve dhe zhvillimin ekonomik lokal; edhe pse sa i përket zhvillimit ekonomik nga praktika është parë se komunat mund të ofrojnë pak në përkrahjen e drejtpërdrejt bizneseve lokale. Sipas zyrtarëve të komunave të regjionit të Prizrenit, ato janë duke u mundur që të punojnë në krijimin e kushteve më të përshtatshme dhe favorizuese për zhvillimin e ekonomisë së vogël dhe të mesme¹; mirëpo ata theksojnë që ndonjëherë kjo përkrahje është shumë e kufizuar marr parasysh funksionin dhe kompetencat e tyre.

a. Korniza ligjore dhe cikli i planifikimit për bërjen dhe realizimin e buxhetit komunal


Korniza ligjore për bërjen dhe realizimin e buxhetit komunal bazohet në ligjet e mëposhtme:

- Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal
- Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit
- Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe
- Ligjin për Kufijtë Administrativ Komunal

Duhet theksuar që Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prior-

itetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme tri vjeçare. Me KAB paraqiten shpjegimet e politikave dhe prioritetëve të komunave; po ashtu edhe projeksionet e ardhme me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush dhe përkrah projektet me prioritet.

Bazuar në kornizën e lartpërmendur ligjore dhe me qëllim që ky proces të jetë i hapur, transparente dhe llogaridhënës, procesi i planifikimit të buxhetit të komunës ka ciklin e vet i cili duhet të inkorporoj të gjitha fazat e cekura më poshtë:



a. Karakteristikat kryesore të realizimit të buxhetit komunal në regjionin e Prizrenit

Rajoni i Prizrenit është i përberë nga komunat e Prizrenit, Rahovecit, Suharekës, Malishevës, Dragashit dhe Mamushës. Konfiguracioni i këtyre komunave siguron parakushte për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Kjo për arsye se kanë potencial ekzistues në zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, industrisë ushqimore dhe turizmit. Po ashtu në bazë të vendosjes së saj gjeografike ky regjion ka një pozicion strategjik dhe afërsia e këtyre komunave nga autostrada që është duke u ndërtuar i mundëson atyre që të lidhen me pjesët tjera të gadishullit ballkanik dhe të zhvillojnë sektorin e ekonomisë së vogël dhe mesme si parakusht për krijimin e një mirëqenie më të mirë shoqërore. Konteksti politik në komunat e regjionit të Prizrenit tregon që ka një stabilitet që siguron një ambient të qetë për qytetaret e saj.

Gjatë përpilimit të Buxhetit të Komunës duhet të merret parasysh që propozim buxheti duhet të planifikohet, përgatitet në mënyrë të transparente dhe bazohet në legjislacion dhe udhëzimet administrative. Buxheti në vete gërsheton planin e veprimit dhe është udhërrëfyes ekonomik për një vit fiskal dhe në vete përfshin të gjitha parashikimet e të hyrave, shpenzimeve kapitale e të përditshme të Komunës.

Buxheti komunal formohet nga të hyrat vetanake të komunës, grantet qeveritare, grantet e jashtëzakonshme dhe të gjitha të hyrat të cilat mblidhen përmes aktiviteteve të ushtruara në komuna.

Indikatorët që janë përdorur për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna janë: Popullsia llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); numri i popullsisë pakicë (3%); komunat, shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare me dy përqind (2%); dhe përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%).

Viti 2011						
	Shuma fikse	Granti i Popullatës	Granti i popullatës minoritare në Komuna	Granti i Komunave minoritare në Kosove	Granti i sipërfaqes	Totali
Dragash	105,000	1,422,500	339,974	-	241,883	2,109,357
Malishevë	88,000	2,113,428	736	-	172,131	2,374,295
Mamushë	134,000	243,857	-	94,111	18,001	489,969
Prizren	-	8,736,710	790,522	-	339,199	9,866,431
Rahovec	77,000	2,560,500	51,331	-	156,380	2,845,211
Suharekë	60,000	3,251,428	12,379	-	203,069	3,526,877

Tab1. Granti i ndarjes për komunat e regjionit të Prizrenit sipas Vendimit të Komisionit të Granteve për Financimin Komunal 2011-2013²

Shpenzimet komunale paraqesin të dalat e domosdoshme që kanë për qëllim funksionimin normal të komunës dhe njëkohësisht edhe ofrimin e shërbimeve të mirëfillta për qytetaret e saj. Si pjesë e këtyre të dalave janë: Pagat, Mallrat dhe Shërbimet, Shpenzimet komunale, Subvencionet dhe Investimet kapitale.

i. Të hyrat

Nëse shikohen të gjitha të hyrat në komunat e regjionit të Prizrenit (Prizren, Suharekë, Dragash, Mamushë, Malishevë, dhe Rahovec) do të shihet se që nga viti 2007 deri në vitin 2010 është shënuar një rritje në vlerën e buxhetit me të cilën kanë operuar këto komuna gjatë viteve përkatëse; apo shikuar për çdo vit në tabelën vijuese:

Totali të Hyrat				
Komunat	2007	2008	2009	2010
Prizren	16,601,000.00 €	18,194,000.00 €	23,800,000.00 €	25,229,784.00 €
Suharekë	6,642,000.00 €	6,919,000.00 €	8,682,000.00 €	9,205,000.00 €
Dragash	2,743,143.77 €	2,753,000.00 €	3,879,000.00 €	4,565,000.00 €
Mamushë	0.00 €	452,000.00 €	722,000.00 €	770,000.00 €
Malishevë	4,982,000.00 €	5,369,000.00 €	6,618,000.00 €	7,663,000.00 €
Rahovec	5,305,000.00 €	5,339,000.00 €	7,051,000.00 €	7,722,000.00 €
Totali	36,273,143.77 €	39,026,000.00 €	50,752,000.00 €	55,154,784.00 €

Bazuar në të dhënat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, përqindja (%) e të hyrave të akorduara për kokë banori nga Granti Qeverisë gjatë katër viteve të fundit për komunat e regjionit të Prizrenit është sikurse është paraqitur në tabelën vijuese:

Te Hyrat - Granti %				
Komunat	2007	2008	2009	2010
Prizren	73.15	75.85	80.39	83.71
Suharekë	73.83	79.74	83.45	86.89
Dragash	82.89	90.16	89.1	90.32
Mamushë	0	92.04	92.8	97.79
Malishevë	93.66	88.68	91.12	91.66
Rahovec	79.23	82.88	86.7	91.54

Me qëllim të thjeshtësimit si të hyra vetanake të komunës janë llogaritur të gjitha të hyrat nga burimet në vijim: faturat e tatimit në pronë, taksat komunale, gjogat, donacionet e brendshme dhe jashtme, tarifatat dhe pagesat tjera në pajtim me autoritetin që u është dhënë komunave me Ligjin për Financat Publike Lokale (LFPL).

Te Hyrat Vetanake				
Komunat	2007	2008	2009	2010
Prizren	4,457,000.00 €	4,393,000.00 €	4,667,000.00 €	4,110,592.00 €
Suharekë	1,738,000.00 €	1,402,000.00 €	1,437,000.00 €	1,207,000.00 €
Dragash	469,235.83 €	271,000.00 €	423,000.00 €	442,000.00 €
Mamushë	0.00 €	36,000.00 €	52,000.00 €	17,000.00 €
Malishevë	316,000.00 €	608,000.00 €	588,000.00 €	639,000.00 €
Rahovec	1,102,000.00 €	914,000.00 €	938,000.00 €	653,000.00 €

Apo e paraqitur në përqindje:

Te Hyrat Vetanake %				
Komunat	2007	2008	2009	2010
Prizren	26.85	24.15	19.61	16.29
Suharekë	26.17	20.26	16.55	13.11
Dragash	17.11	9.84	10.9	9.68
Mamushë	0	7.96	7.2	2.21
Malishevë	6.34	11.32	8.88	8.34
Rahovec	20.77	17.12	13.3	8.46

Nga tabela e mëposhtme do të nxjerrët përfundimi se bazuar në formulën (të hyrat totale³ / numri i popullsisë⁴) gjatë katër (4) vitet e fundit kemi një ngritje të të hyrave të përgjithshme në komuna të regjionit të Prizrenit për kokë banori. Derisa p.sh. këto të hyra në vitin 2007 ishin: Prizren-93.21 €, Suharekë-111.25 €, Dragash-81.68 €, Malishevë-91.14 € dhe Rahovec 96.36 €; Në vitin 2010 këto vlera u rriten për: Prizren-141.65 €, Suharekë-154.18 €, Dragash-135.93 €, Mamushë 139.67 €, Malishevë 140.18 € dhe Rahovec 140.26 €; apo shikuar për çdo vit në tabelën vijuese:

Të Hyrat - totali (per capita)				
	2007	2008	2009	2010
Prizren	93.21 €	102.15 €	133.62 €	141.65 €
Suharekë	111.25 €	115.89 €	145.42 €	154.18 €
Dragash	81.68 €	81.97 €	115.50 €	135.93 €
Mamushë	0.00 €	81.99 €	130.96 €	139.67 €
Malishevë	91.14 €	98.22 €	121.07 €	140.18 €
Rahovec	96.36 €	96.98 €	128.08 €	140.26 €

Nga tabela e mëposhtme do të nxjerrët përfundimi se bazuar në formulën (të hyrat vetanake⁵ / numri i popullsisë⁶) se gjatë katër (4) vitet e fundit kemi lëvizje rënëse në aftësinë gjeneruese të të hyrave vetanake në komuna të regjionit të Prizrenit. Derisa ne vitin 2007 komuna të rajonit tone kishin realizuar Prizren-25.02 €, Suharekë-29.11 €, Dragash-13.97 €, Malishevë 5.78 € dhe Rahoveci 20.02 €, ne vitin 2010 vetëm komuna e Malishevës kishte një ngritje të theksuar (me 11.69 €) në gjenerimin e të hyrave vetanake krahasuar me vitet paraprake; apo shikuar për çdo vit në tabelën vijuese:

Të Hyrat vetanake (per capita)				
	2007	2008	2009	2010
Prizren	25.02 €	24.66 €	26.20 €	23.08 €
Suharekë	29.11 €	23.48 €	24.07 €	20.22 €
Dragash	13.97 €	8.07 €	12.60 €	13.16 €
Mamushë	0.00 €	6.53 €	9.43 €	3.08 €
Malishevë	5.78 €	11.12 €	10.76 €	11.69 €
Rahovec	20.02 €	16.60 €	17.04 €	11.86 €

ii. Të dalat - Pagat

Në kategorinë e të dalave janë të përfshira bruto-pagat e stafit të administratës lokale (me shërbimin e zjarrfikësve dhe me zyrën për komunitete) me pagesën për punët e kontraktuara, puna jashtë orarit dhe pagesat për asamblistë. Sipas Raporteve të Auditimit të Rregullsisë⁷ në Komuna për vitin 2010 në regjionin e Prizrenit në fund të vitit 2010 kishte të punësuar: Suhareka 1300, Rahoveci 1161, Mamusha 122, Malisheva 1314, Dragashi 758, dhe Prizreni 3222. Nga ajo që shihet, vetëm Prizreni e tejkalon për 45 punëtor normën nga ajo që lejohet me Ligjin⁸ për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011 Nr. 04/L-001. Neni 11 i këtij Ligji thekson “Nga secila organizatë buxhetore kërkohet të sigurojë që gjatë vitit fiskal 2011 në asnjë moment të mos kalojë numrin e pozitave në total të punësimit të specifikuar në Tabelat 3.1. dhe 4.1 të bashkëngjitur në këtë ligj.”

Nëse shikohet pozicioni i Pagave në të dalat e komunave të regjionit të Prizrenit (Prizren, Suharekë, Dragash, Mamushë, Malishevë, dhe Rahovec) do të shihet se që nga viti 2007 deri në vitin 2010 është shënuar një rritje; apo shikuar për çdo vite në tabelën vijuese:

Pagat				
Komunat	2007	2008	2009	2010
Prizren	7,732,993.00 €	8,671,253.00 €	10,111,816.00 €	11,129,125.00 €
Suharekë	3,291,000.00 €	3,629,000.00	4,233,000.00	4,596,000.00
Dragash	1,771,065.57 €	1,852,000.00	2,180,000.00	2,451,000.00
Mamushë	0.00 €	269,000.00	410,000.00	507,000.00
Malishevë	3,045,000.00 €	3,501,000.00	3,994,000.00	4,394,000.00
Rahovec	2,892,000.00 €	3,154,000.00	3,674,000.00	3,996,000.00

Apo duke përdor formulën (Shpenzimi i pagave*100/Buxheti tërësishëm për atë vit) do të kemi një pasqyrë mbi pozicionin e pagave për të gjitha vitet e shqyrtuara. Nga tabela e mëposhtme mund të shihet se krahasuar me vitin 2007 në vitin 2010 komunat e Prizrenit, Dragashit, Malishevës dhe Rahovecit kanë trend zvogëlues të këtij shpenzimi, derisa komuna e Mamushës (65.84%) dhe Suharekës (49.93%) ka një ngritje krahasuar me buxhetin e tërësishëm të komunës.

Pagat %				
Komunat	2007	2008	2009	2010
Prizren	46.56	47.66	42.49	44.11
Suharekë	49.55	52.42	48.76	49.93
Dragash	64.56	67.27	56.2	53.77
Mamushë	0	59.51	56.79	65.84
Malishevë	62.08	65.21	60.42	57.34
Rahovec	52.27	59.07	52.11	51.75

iii. Të dalat - Mallrat dhe Shërbimet

Sa i përket pozicionit të Mallrave dhe Shërbimeve në komunat e regjionit të Prizrenit gjatë periudhës katër vjeçare kemi një trend valor. Derisa në vitin 2007 komunat e rajonit tonë ishin: Prizren-2,055,555 €, Suharekë-882,000 €, Dragash-385,799 €, Malishevë 682,000 € dhe Rahoveci 724,000 €; në vitin 2010 marr parasysh normën e inflacionit dhe dobësimin e fuqisë blerëse të Euros këto shpenzime janë lokalizuar apo edhe zvogëluar. Është interesante që krahasuar me vitin paraprakë në vitin 2008 dhe 2010 paraqitet ngritje të këtij pozicioni, apo siç theksohet ne tabelën mposht:

Mallrat dhe Shërbimet				
Komunat	2007	2008	2009	2010
Prizren	2,055,555.00 €	2,369,348.00 €	2,145,014.00 €	2,340,380.00 €
Suharekë	882,000.00 €	904,000.00	791,000.00	817,000.00
Dragash	385,799.42 €	386,000.00	343,000.00	368,000.00
Mamushë	0.00 €	103,000.00	103,000.00	112,000.00
Malishevë	682,000.00 €	764,000.00	740,000.00	656,000.00
Rahovec	724,000.00 €	678,000.00	656,000.00	595,000.00

Duke përdor formulën (Shpenzimi i Mallrave dhe shërbimeve*100/Buxheti tërësishëm për atë vit) do të kemi një pasqyrë ne përqindje mbi këtë pozicion për të gjitha vitet e shqyrtuara. Nga tabela e mëposhtme mund të shihet se krahasuar me vitin 2007 në vitin 2010 komunat e Prizrenit, Suharekës, Dragashit, Malishevës dhe Rahovecit kanë trend zvogëluar të këtij shpenzimi, mirëpo ky trend paraqitet për shkak te rritjes së buxhetit te tërësishëm të komunës.

Mallrat dhe Shërbimet %				
Komunat	2007	2008	2009	2010
Prizren	12.38	13.02	9.01	9.28
Suharekë	13.28	13.06	9.11	8.88
Dragash	14.06	14.02	8.84	8.07
Mamushë	0	22.79	14.27	14.55
Malishevë	13.9	14.23	11.2	8.56
Rahovec	14.12	12.7	9.3	7.71

iv. Të dalat - Shpenzimet Komunale

Sa i përket pozicionit të Shpenzimeve komunale në komunat e regjionit të Prizrenit në vitin 2007 ato ishin: Prizren-992,900 €, Suharekë-193,000 €, Dragash-86,500 €, Malishevë 151,000 € dhe Rahoveci 315,000 €; Gjatë periudhës katër vjeçare në Komunën e Prizreni kemi një trend të uljes ndërsa ne komunat e Suharekës, Dragashit, Malishevës, Mamushës dhe Rahovecit kemi një ngritje te lehtë mirëpo marr parasysh normën e inflacionit dhe dobësimin e fuqisë blerëse të Euros këto shpenzime janë lokalizuar.

Shpenzimet Komunale				
Komunat	2007	2008	2009	2010
Prizren	992,900.00 €	656,964.00 €	543,207.00 €	616,552.00 €
Suharekë	193,000.00 €	195,000.00	232,000.00	201,000.00
Dragash	86,500.00 €	88,000.00	94,000.00	95,000.00
Mamushë	0.00 €	13,000.00	24,000.00	21,000.00
Malishevë	151,000.00 €	157,000.00	160,000.00	156,000.00
Rahovec	315,000.00 €	275,000.00	164,000.00	268,000.00

Apo duke përdor formulën (Shpenzimet komunale*100/Buxheti tërësishëm për atë vit) do të kemi një pasqyrë në përqindje mbi këtë pozicion për të gjitha vitet e shqyrtuara. Nga tabela e mëposhtme mund të shihet se krahasuar me vitin 2007 në vitin 2010 komunat e Prizrenit, Suharekës, Dragashit, Malishevës dhe Rahovecit kanë trend zvogëlues të këtij shpenzimi. Mirëpo duhet theksuar se ky trend ulës në përqindje paraqitet për shkak të rritjes së shumës së përgjithshme të buxhetit komunal dhe jo për shkak të zvogëlimit nominal në vlerë monetare.

Shpenzimet Komunale %				
Komunat	2007	2008	2009	2010
Prizren	5.98	3.61	2.28	2.44
Suharekë	2.91	2.82	2.67	2.18
Dragash	3.15	3.2	2.42	2.08
Mamushë	0	2.88	3.32	2.73
Malishevë	3.08	2.92	2.42	2.04
Rahovec	5.69	5.15	2.33	3.47

v. Të dalat - Subvencionet

Sipas zyrtareve komunal⁹, sa i përket pozicionit të subvencioneve, kryesisht shpenzohet për raste të ndihmave, si ato shëndetësore, sociale, ekonomiko-materiale, ndihma për student (bursa), etj. Pozicioni i Subvencioneve në komunat e regjionit të Prizrenit në vitin 2007 ishte: Prizren-292,992 €, Suharekë-103,000 €, Dragash-25,200 €, Malishevë 58,000 € dhe Rahoveci 66,000 €; Gjatë periudhës katër vjeçare në të gjitha Komunat e regjionit të Prizrenit kemi një trend të rritjes së lehtë.

Subvencionet				
Komunat	2007	2008	2009	2010
Prizren	292,992.00 €	314,422.00 €	346,555.00 €	372,004.00 €
Suharekë	103,000.00 €	110,000.00	119,000.00	105,000.00
Dragash	25,200.00 €	37,000.00	46,000.00	32,000.00
Mamushë	0.00 €	0.00 €	0.00 €	1,000.00
Malishevë	58,000.00 €	55,000.00	60,000.00	60,000.00
Rahovec	66,000.00 €	66,000.00	97,000.00	120,000.00

Apo duke përdor formulën (Subvencionet *100/Buxheti tërësishëm për atë vit) do të kemi një pasqyrë në përqindje mbi këtë pozicion për të gjitha vitet e shqyrtuara. Nga tabela e mëposhtme mund të shihet se krahasuar me vitin 2007 në vitin 2010 komunat e Prizrenit, Suharekës, Dragashit, Malishevës, Rahovecit dhe Mamushës kanë trend zvogëlues të këtij shpenzimi. Mirëpo duhet theksuar se ky trend degresiv në përqindje paraqitet për shkak të rritjes së shumës së përgjithshme të buxhetit komunal dhe jo për shkak të zvogëlimit në vlerë monetare.

Subvencionet %				
Komunat	2007	2008	2009	2010
Prizren	1.76	1.73	1.46	1.47
Suharekë	1.55	1.59	1.37	1.14
Dragash	0.92	1.34	1.19	0.7
Mamushë	0	0	0	0.13
Malishevë	1.18	1.02	0.91	0.78
Rahovec	1.19	1.24	1.38	1.55

vi. Të dalat - Investimet kapitale

Sa i përket pozicionit të Investimeve kapitale në komunat e regjionit të Prizrenit në vitin 2007 ato ishin: Prizren-5,533,363 €, Suharekë-2,173,000 €, Dragash-474,578 €, Malishevë 969,000 € dhe Rahoveci 1,130,000 €; Gjatë periudhës katër vjeçare në të gjitha Komunat e regjionit të Prizrenit kemi një trend të rritjes progresive e cila reflektohet me realizimin e projekteve madhore për krijimin e kushteve të mirëfillta për të gjithë qytetaret e komunave të regjionit të Prizrenit.

Investimet Kapitale				
Komunat	2007	2008	2009	2010
Prizren	5,533,363.00 €	6,182,702.00 €	10,652,420.00 €	10,771,722.00 €
Suharekë	2,173,000.00 €	2,085,000.00	3,307,000.00	3,486,000.00
Dragash	474,578.78 €	390,000.00	1,216,000.00	1,612,000.00
Mamushë	0.00 €	67,000.00	185,000.00	129,000.00
Malishevë	969,000.00 €	892,000.00	1,656,000.00	2,397,000.00
Rahovec	1,130,000.00 €	1,166,000.00	2,460,000.00	2,743,000.00

Apo duke përdor formulën (Investimet kapitale *100/Buxheti tërësishëm për atë vit) do të kemi një pasqyrë në përqindje mbi këtë pozicion për të gjitha vitet e shqyrtuara. Nga tabela e mëposhtme mund të shihet se krahasuar me vitin 2007 në vitin 2010 komunat e Prizrenit, Suharekës, Dragashit, Malishevës, Rahovecit dhe Mamushës kemi një trend progresiv të këtij pozicioni buxhetor.

Investimet Kapitale %				
Komunat	2007	2008	2009	2010
Prizren	33.32	33.98	44.76	42.69
Suharekë	32.72	30.12	38.09	37.87
Dragash	17.3	14.17	31.35	35.37
Mamushë	0	14.82	25.62	16.75
Malishevë	19.76	16.61	25.05	31.28
Rahovec	20.42	21.84	34.89	35.52

vii. Totali i shpenzimeve

Sa i përket totalit të shpenzimeve buxhetore në komunat e regjionit të Prizrenit krahasuar me vitin 2007 gjatë periudhës katër vjeçare kemi një trend të rritjes progresive e cila shënon dyfishim të saj në vitin 2010, apo siç theksohet në tabelën më poshtë:

Totali shpenzimeve				
Komunat	2007	2008	2009	2010
Prizren	16,607,803.00 €	18,194,689.00 €	23,799,012.00 €	25,229,783.00 €
Suharekë	6,642,000.00 €	6,923,000.00 €	8,682,000.00 €	9,205,000.00 €
Dragash	2,743,143.77 €	2,753,000.00 €	3,879,000.00 €	4,558,000.00 €
Mamushë	0.00 €	452,000.00 €	722,000.00 €	770,000.00 €
Malishevë	4,905,000.00 €	5,369,000.00 €	6,610,000.00 €	7,663,000.00 €
Rahovec	5,533,000.00 €	5,339,000.00 €	7,051,000.00 €	7,722,000.00 €

viii. Qasja në dokumente zyrtare dhe mendimi i zyrtarëve komunal¹⁰

Gjatë bërjes së këtij punimi, zyrtarët e Institutit Demokratik kanë kontaktuar zyrtaret gjegjës të komunave të regjionit të Prizrenit dhe nga të njëjtit kanë kërkuar qasje në dokumentin e realizimit të buxhetit komunal për vitet 2008, 2009 dhe 2010; duhet theksuar se në përputhje me legjislacionin në fuqi në komunat e Prizrenit, Suharekës, Malishevës, Rahovecit, Dragashit dhe Mamushës qasja në këtë dokument ka qenë shumë e lehtë dhe zyrtaret e drejtorisë për ekonomi dhe financa ishin shumë bashkëpunues me rastin e plotësimit të pyetësorit.

Gjatë bisedave me zyrtarët e Komunave të regjionit të Prizrenit, është theksuar se komunat synojnë që në maksimum ta realizojnë buxhetin dhe kjo sipas tyre mund të verifikohet edhe në bazë të raporteve nga thesari qendror. Zakonisht sipas legjislacionit në fuqi këto komuna duhet të raportojnë dy herë në vit apo edhe më tepër nëse ka kërkesë nga kuvendi. Mënyra e raportimit të tanishëm karakterizohet si më e mirë krahasuar me atë që ishte në të kaluarën dhe për këtë ata theksojnë se merita i takon këshilltarëve të kuvendit komunal të cilët kërkuar modifikime në mënyrën e raportimit me qëllim që ai të jetë më i kuptueshëm për shqyrtim. Në shumë komuna është theksuar problemi i shpenzimeve të mirëmbajtjes së objekteve shkollore andaj sipas zyrtarëve është e nevojshme të rritet pozicioni i shpenzimeve komunale ndërsa të zvogëlohet ai i Mallrave dhe shërbimeve.

Në shumë komuna është theksuar se legjislacioni ekzistues krijon kushte të mira për mbarëvajtjen e aktiviteteve komunale; edhe pse shumë zyrtar kanë përmendur se është e nevojshme që disa kompetenca në lidhje me përkrahjen e biznesit duhet të barten në nivel lokal apo edhe të bëhen investime shtesë në krijimin e resurseve humane në fushën e biznesit¹¹. Në disa komuna është shprehur si e domosdoshme që të bëhet zhvendosja e qendrave të mëdha tregtare në periferi, për arsye të ndikimit të tyre negativë në afarizmin e ndërmarrjeve të vogla tregtare në qytet¹². Ka pas kërkesa që për disa projekte është e domosdoshme që të bëhen konsultime edhe me shoqatat e zëjtareve të këtyre komunave. Në disa raste është cilësuar si pozitive edhe ulja e normave tatimore në disa komuna të regjionit dhe ofrimi i lehtësirave të ndryshme si mënyrë për ndihmësen e biznesit.

Të gjithë zyrtaret komunal kanë theksuar se bashkëpunimi i tyre me stafin udhëheqës është shumë i mirë dhe të gjitha sugjerimet e tyre merren parasysh. Në përputhje me qarkoren buxhetore dhe udhëzimet gjegjëse, të gjithë drejtorët komunal potencuan se kanë mbajtur takime me grupet e tyre të interesit dhe sugjerimet e tyre në masë të konsiderueshme janë reflektuar në propozim buxhetin për vitin vijues. Sa i përket dëgjimeve publike, të gjithë zyrtarët e komunave të regjionit të Prizrenit kanë shprehur zhgënjimin me pjesëmarrjen e ulët të qytetareve në këto takime; gjë që ka ndikuar që në disa raste kryetarët e këtyre komunave të kenë qasje pro-aktive dhe kanë organizuar takime me publikun edhe në zona rurale.

c. Sfidat kryesore gjatë bërjes së buxhetit komunal

Ndër sfidat kryesore në procesin e bërjes së buxhetit komunal janë identifikuar:

- Përcaktimi i kufizimeve buxhetore për komunat të cilat janë rrjedhojë e kufizimeve që kanë institucionet e vetëqeverisjes nga kërkesat e Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.
- Mungesa e njohurive të zyrtarëve komunalë për hartimin e projekt propozimeve, strategjive dhe realizimin e tyre; njëkohësisht komunat kanë mungesë të resurseve humane (grupe te eksperteve) me qëllim të aplikimit për fonde tek organizatat donatore.
- Mungesa e postimit të Projekt Buxhetit për vitin vijues dhe Raportit të Realizimit të Buxhetit të Komunës në ueb faqet e zyrtare, dhe azhurnimi i mirëfilltë i tyre nga ana e komunave të regjionit të Prizrenit; Paraqitja e raportit tre mujor financiar dhe raportimi i rregullt në baze tre mujore pranë kuvendit të komunës.
- Pjesëmarrja e dobët e qytetareve dhe grupeve të interesit në dëgjimet publike me rastin e bërjes së buxhetit komunal për shkak të mos përfshirjes së sugjerimeve të tyre në projektet me prioritet të komunës.
- Kompetencat e kufizuara në përkrahjen e drejtpërdrejt të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
- Mos ekzistimi i një sistemi të unifikuar të raportimit në të gjitha komunat e regjionit të Prizrenit i cili në vete do të gërshetonte të dhënat mbi realizimet dhe shpenzimeve buxhetore të raportuara në baza mujore.¹³
- Mungesa e një praktike të raportimit të OJQ-ve për projektet e financuara nga ana e buxhetit të konsoliduar të Kosovës; njëkohësisht edhe nuk ekziston një regjistër me të

dhënave e organizatave joqeveritare, që përmban informata mbi aktivitetet e realizuara të tyre në nivel komunal.

- Në disa komuna, Drejtoret për Ekonomi dhe Financa kanë theksuar nevojën për trajnime shitesë të personelit në programet e kontabilitetit dhe programet tjera të cilat mundësojnë analizën e lëvizjeve buxhetore dhe ofrojnë këshilla për procesin vendimmarrës të stafin udhëheqës.

II. Rekomandimet

Ndër rekomandimet që kanë rrjedh gjatë takimeve me zyrtarët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile të komunave të regjionit të Prizrenit janë:

- Është e domosdoshme që të bëhet postimi i Raportit të Realizimit të Buxhetit të Komunës në ueb faqet e zyrtare, dhe azhurnimi i mirëfilltë i tyre nga ana e komunave të regjionit të Prizrenit, njëkohësisht sugjerohet edhe postimi i raporteve tremujore financiare.

- Aftësimi i zyrtarëve komunalë për hartimin e strategjive, hartimin e projekt propozimeve dhe realizimin e tyre dhe krijimi i ekipit të përzier ekspertëve me qëllim të aplikimit për fonde tek organizatat donatore të huaja.

- Aftësimi i zyrtareve të drejtorisë për ekonomi dhe financa në programet e kontabilitetit dhe programet tjera të cilat mundësojnë analizën e lëvizjeve buxhetore dhe ofrojnë këshilla për procesin vendimmarrës të stafin udhëheqës.



- Krijimi i kanaleve të komunikimit dhe ndërtimi partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal dhe organizatave të shoqërisë civile; këtu është sugjeruar edhe të krijohet një pozicion buxhetor për përkrahjen e projekteve të shoqërisë civile¹⁴;

- Njëkohësisht rekomandohet që të krijohet një praktikë e raportimit të OJQ-ve për projektet e financuara nga ana e Kuvendeve Komunale; dhe krijimi i bazës së të dhënave të shoqërisë civile, ku do të regjistrohen të dhënat për OJQ-të të cilat kanë përfituar nga donacionet e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

Aneks 1.

Trendi i realizimit të të hyrave të Komunes së Prizrenit për vitet 2008-2009-2010

Trendi i të dalave të Komunes së Prizrenit për vitet 2008-2009-2010



Tabelat e realizimit të hyrave dhe të dalave të Komunës së Prizrenit për vitet 2008-2009-2010.

18

Komuna e Prizrenit

Të hyrat	
Janar 2008	€ 228,626.50
Shkurt 2008	€ 281,672.13
Mars 2008	€ 292,221.21
Prill 2008	€ 415,904.44
Maj 2008	€ 341,169.92
Qershor 2008	€ 390,978.96
Korrik 2008	€ 377,440.08
Gusht 2008	€ 747,150.12
Shtator 2008	€ 301,200.43
Tetor 2008	€ 296,577.97
Nëntor 2008	€ 312,049.19
Dhjetor 2008	€ 555,172.09
Janar 2009	€ 215,661.71
Shkurt 2009	€ 295,757.74
Mars 2009	€ 268,387.63
Prill 2009	€ 513,720.13
Maj 2009	€ 287,621.39
Qershor 2009	€ 444,540.82
Korrik 2009	€ 369,683.40
Gusht 2009	€ 424,244.70
Shtator 2009	€ 436,206.68
Tetor 2009	€ 273,882.59
Nëntor 2009	€ 239,072.16
Dhjetor 2009	€ 573,522.54
Janar 2010	€ 257,416.00
Shkurt 2010	€ 273,018.00
Mars 2010	€ 285,595.00
Prill 2010	€ 258,656.00
Maj 2010	€ 389,016.00
Qershor 2010	€ 521,337.00
Korrik 2010	€ 542,723.00
Gusht 2010	€ 383,052.00
Shtator 2010	€ 370,075.00
Tetor 2010	€ 410,877.00
Nëntor 2010	€ 431,190.00
Dhjetor 2010	€ 657,586.00
Janar 2011	€ 442,119.00
Shkurt 2011	€ 276,363.00
Mars 2011	€ 502,271.00
Prill 2011	€ 318,113.00
Maj 2011	€ 680,838.00
Qershor 2011	€ 375,860.00

Shpenzimet	
Janar 2008	151,910.00 €
Shkurt 2008	808,220.00 €
Mars 2008	852,235.00 €
Prill 2008	2,337,861.00 €
Maj 2008	994,965.00 €
Qershor 2008	1,854,578.00 €
Korrik 2008	1,558,600.00 €
Gusht 2008	1,132,112.00 €
Shtator 2008	2,294,192.00 €
Tetor 2008	1,900,921.00 €
Nëntor 2008	1,314,928.00 €
Dhjetor 2008	2,994,166.00 €
Janar 2009	54,167.34 €
Shkurt 2009	2,431,847.61 €
Mars 2009	1,768,481.39 €
Prill 2009	1,802,500.82 €
Maj 2009	2,356,022.58 €
Qershor 2009	1,774,867.62 €
Korrik 2009	1,982,213.50 €
Gusht 2009	2,636,343.33 €
Shtator 2009	2,428,356.96 €
Tetor 2009	2,623,472.51 €
Nëntor 2009	2,055,278.91 €
Dhjetor 2009	1,885,459.86 €
Janar 2010	0 €
Shkurt 2010	2,747,639.00 €
Mars 2010	1,923,350.00 €
Prill 2010	2,049,259.00 €
Maj 2010	1,846,701.00 €
Qershor 2010	2,339,290.00 €
Korrik 2010	2,173,925.00 €
Gusht 2010	2,204,959.00 €
Shtator 2010	2,125,888.00 €
Tetor 2010	2,027,945.00 €
Nëntor 2010	2,146,880.00 €
Dhjetor 2010	3,644,713.00 €
Janar 2011	133,100.00 €
Shkurt 2011	1,918,071.00 €
Mars 2011	202,597.00 €
Prill 2011	5,243,822.00 €
Maj 2011	2,433,808.00 €
Qershor 2011	2,301,094.00 €

ENHANCEMENT OF CIVIL PARTICIPATION

in preparation and realization
of the municipal budget



 **KDI**
Instituti Demokratik i Kosovës
Kosova Democratic Institute
www.kdi-kosova.org

October 2011

Index

20

I. Preface	21
a. Legal framework and planning cycle for drafting and implementation of the municipal budget	21
b. Main characteristics for realization of the municipal budget in Prizren	21
i. Incomes	24
ii. Expenditures - Salaries	26
iii. Expenditures - Goods and services	27
iv. Expenditures - Municipal expenditures	27
v. Expenditures - Capital investments	28
vi. Total of expenditures	29
vii. Access to official documents and opinion of the municipal officials.....	29
c. Main challenges for preparation of the municipal budget	31
II. Recommendations	32
Annex 1	33
Endnotes	36

I. Foreword

The process for preparation of the municipal budget is one of the main functions of the local governance, because it reflects the annual needs and priorities of respective municipality. During this process should be undertaken authentic planning and the process as such should be open for all groups of interest in order to reflect better the interests of citizens.

Civic participation in planning and preparation of the municipal budget is one of the main aspects for creation of the open, transparent and accountable governance at the local level; its aim is to support local governance in performance of its functions and in the meantime enable establishment of the good practices of democratic governance at the municipal level. In order to achieve the success for this process, it is necessary that municipal officials' prior to endorsement of the budget for the coming year to: 1) inform citizens about initiation of this process; 2) to organize public hearings and take into account the requests and suggestions of citizens and groups of interest; 3) to publish draft budget prior to its endorsement and ensure free access in this document, and lastly 4) to enable the inclusion of the citizens and civil society to monitor entire process.

